REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 06-01/725/21
Nr. faq. Broj stranica Nr. pages 05
Data Datum Date 05-03.2021
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04.03.2021
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-2199/20 – 06-2353/19
PËR/ZA/TO:	z. Agron Shala, Kryesues i Këshillit Drejtues në Teatrin Kombëtar të Kosovës
CC:	z. Naser Shatrolli, U.D. Drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës z. Ardian Morina, U.D. Udhëheqës Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**OPINION** lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit

I nderuari z. Shala,

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar dy kërkesa me nr.(06-2199/20) dhe (06-2353/19) për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Njëra lidhur angazhimin e ish. U.D. Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe tjera për angazhimin e U.D. Udhëheqësit Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit konform kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në cilësinë e autoriteti qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të, Ligjit në fjalë, në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 21 (paragrafi 1, nën paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.7) të LPKI-së, pas vlerësimit të rrethanave lidhur me rastin konkret, Agjencia ofron këtë:

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri" Nr. 31, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

OPINION

Sipas nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-104 për Teatrot, Drejtori dhe Udhëheqësi Artistik i Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk mund të angazhohen në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Lidhur me këto situata të shfaqura në Teatrin Kombëtar të Kosovës, Agjencia kundër Korrupsionit ofron sqarimet si vijon:

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar dy kërkesa me pretendime për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesi lidhur angazhimin e ish. U.D. Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës, dhe angazhimin e U.D. Udhëheqësit Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Qëllimi i Agjencisë kundër Korrupsionit është që situatat e konfliktit të interesit të parandalohen dhe të zgjidhen në burim nga vetë zyrtari publik, institucioni përkatës si dhe përmes autoritetit përgjegjës për trajtimin e situatave të konfliktit të interesit, pa krijuar pasoja juridike.

Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës, me rastin e emërimit të Drejtorit dhe Udhëheqësit Artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës, duhet të garantoj mbikëqyrje të drejtë lidhur me angazhimet në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës duhet të garantoj zbatimin e rregullave të brendshme të institucionit lidhur me ndalesat e përcaktuara për Drejtorin dhe Udhëheqësin Artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës, lidhur me angazhimet në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Në rastet konkrete, nuk e dimë nëse Këshilli Drejtues i Teatrit si dhe organet tjera përgjegjëse në TKK (vetë zyrtari publik, udhëheqësi i drejtpërdrejtë) i kanë trajtuar këto situata dhe si i kanë vlerësuar ato?

E para; Shkëlzen Veseli, është emëruar U.D. Drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës nga Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës me Vendimin nr. (371) të datës 20.09.2019.
Ndërsa, me Vendimi nr.(379) të datës 27.09.2020 Këshilli Drejtues e ka shkarkuar nga detyra z. Shkëlzen Veseli si U.D. Drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Por, është raportuar në AKK se gjatë ushtrimit një javor të kësaj detyre, z. Veseli, është angazhuar në shfaqjen "Shfaqja e fundit e Marie Gjonit".

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri" Nr. 31, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

E dyta; Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës në mbledhjen e mbajtur të datës 17.10.2019, ka nxjerrë vendimin nr.(402), për emërimin e z. Ardian Morina U.D. Udhëheqës Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Për të luajtur në shfaqjen "Kthimi i Karl Majit" janë përzgjedhë tre aktor rezident të TKK –së dhe një aktor i jashtëm. Në mesin e të përzgjedhurve është z. Ardian Morina U.D. Udhëheqës Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

A keni ndonjë sqarim për këto situata kur dihet se Ligji për Teatrot ka një varg dispozitash që e rregullojnë pikërisht parandalimin e konfliktit të interesit, kjo parashihet në nenin 20 i Ligjit nr. 04/L-104 për Teatrot në të cilën shprehimisht thuhet;

1. Drejtori i përgjithshëm dhe udhëheqësi artistik, gjatë kohës së vazhdimit të mandatit të tyre, mund të veprojnë në mënyrë artistike dhe të zhvillojnë punët e tyre artistike jashtë teatrit ku punojnë vetëm me pëlqimin dhe miratimin me shkrim të Këshillit drejtues të teatrit, i cili në çfarëdo rasti duhet të përmbajë kushtet për kryerjen e punëve të tilla.

2. Drejtori i përgjithshëm, udhëheqësi artistik dhe anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit nuk kanë të drejtë që gjatë mandatit të tyre të merren me punë krijuese të kontraktuara në teatrin ku punojnë.

3. Përjashtim nga paragrafi 2. i këtij neni bën nëse në Këshillin drejtues për anëtarë emërohet ndonjëri nga trupa rezidente e teatrit.

4. Paraqitja e formave tjera të konfliktit të interesit zgjidhet në bazë të ligjeve në fuqi që e rregullojnë këtë fushë.

Përgjegjësit e Drejtori të Teatrit Kombëtar të Kosovës janë të përcaktuara në nenin 14 të Ligjit për Teatrot në të cilin shprehimisht thuhet se;

1. Drejtori i përgjithshëm i Teatrit Publik ka këto përgjegjësi:

1.1. bën menaxhimin financiar, administrativ, teknik dhe promovues të teatrit;
1. 2. zbaton vendimet e Këshillit drejtues të teatrit;
1.3. propozon organizimin e brendshëm të teatrit tek Këshilli drejtues;
1.4. përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
1.5. propozon buxhetin vjetor para Këshillit drejtues;
1.6. kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
1.7. mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe të donacioneve;

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri" Nr. 31, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

1.8. negocion dhe nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet me artistë të pavarur dhe me palë tjera;
1.9. menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së teatrit;
1.10. menaxhon bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
1.11. për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues;

Përgjegjësitë e Udhëheqësit Artistik janë të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit për Teatrot, në të cilën thuhet;

1. Udhëheqësi artistik i teatrit ka këto përgjegjësi:

1.1. propozon politikat artistike të teatrit dhe pas miratimit nga Këshilli drejtues i zbaton ato;
1.2. në konsultim me drejtorin e përgjithshëm bënë propozimin e repertorit artistik vjetor para Këshillit drejtues të teatrit;
1.3. repertorin e zgjeruar në përpjesëtim dy për një e paraqet për miratim para Këshillit drejtues të teatrit, duke krijuar hapësira për afirmimin e krijimtarisë kombëtare;
1.4. udhëheqë punën kreative të ansamblit rezident;
1.5. bën recension për çdo vepër skenike para hyrjes në repertorin vjetor të teatrit;
1.6. është përgjegjës për realizimin e repertorit vjetor të teatrit;
1.7. përcakton regjisorët dhe i ndihmon drejtorit të përgjithshëm në përzgjedhjen e ekipit artistik të shfaqjeve;
1.8. i bën propozim drejtorit të përgjithshëm për bashkëpunim artistik me artistë dhe institucione teatrore vendore dhe ndërkombëtare;
1.9. bashkë me drejtorin e përgjithshëm mbajnë përgjegjësi për çdo shfaqje publike të teatrit;
1.10. për punën e tij e njofton drejtorin e përgjithshëm kurse i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues të teatrit.

Agjencia kundër Korrupsionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, bazës ligjore të përcaktuar në Ligjin nr.04/L-104 për Teatrot, **konstaton se:** Drejtori i Teatrit Kombëtar dhe Udhëheqësi Artistik nuk mund të angazhohen në shfaqjet e Teatrit Kombëtar, për shkak se kjo situatë është e ndaluar me nenin 20 (paragrafi 1) të Ligjit për Teatrot.

Kjo dispozitë ligjore vlenë edhe për U.D Drejtorin e Teatrit Kombëtar dhe U.D Udhëheqësin Artistik, sepse edhe në kuadër të ushtruesve të detyrave ushtrohen të gjitha autorizimet e përcaktuara të vendit të punës.

Pavarësisht se të lartpërmendur janë caktuar në pozitat U.D. Drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe U.D. Udhëheqës Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës nga trupa rezidente e Teatrit, dispozita ligjore e përcaktuar në Teatrin kombëtar të Kosovës e kufizon angazhimin në shfaqjen e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri" Nr. 31, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës që të ndërmerrni veprime të nevojshme me qëllim të shmangies së gjendjes së konfliktit të interesit sipas Ligjit nr.04/L-104 për Teatrot.

Duke qenë se angazhimi i aktorëve rezident në TKK ka impakt në kategorizimin e aktorëve sipas Regullores nr. 04/2019 për themelimin dhe funksionimin e ansamblit rezident të aktorëve të Teatrit Kombëtar dhe të teatrove të qyteteve, duhet të keni parasysh se rolet e angazhuara në situata të konfliktit të interesit nuk mund të shfrytëzohen për kategorizimin e aktorit rezident në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Për veprimet e ndërmarra, lidhur me zbatimin e këtij Opinioni obligohet TKK, të njoftojë Agjencinë kundër Korrupsionit.

Agjencia kundër korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri" Nr. 31, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org